



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA



Procesverbali i mbajtjes së konsultimit publik për Draft-Rregulloren Nr. _____ për plotësim-ndryshim të Rregullores Sh.01 Nr.31251 e datës 29.09.2022 për Kushtet, Kriteret dhe Proceduren e Ndarjes së Subvencioneve.

Takimi publik është organizuar nga Grupi Punues për Draft-Rregulloren Nr. _____ për plotësim-ndryshim të Rregullores Sh.01 Nr.31251 e datës 29.09.2022 për Kushtet, Kriteret dhe Proceduren e Ndarjes së Subvencioneve.

Njoftimet për qytetarë për organizimin e konsultimit janë bërë në përpjekje me legjislacionin në fuqi.

Publikimet janë bërë në Œebfaqen Komunale dhe në Facebook zyrtar të Komunës së Kamenices.

Publikimet:

WEBFAQE:

<https://kamenice.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/02/3090.pdf>

FACEBOOK:

<https://www.facebook.com/KomunaKamenice/posts/pfbid09HiHvU6MDPCkwL48AUr1hv2xWD37qnExikzdZvK5fyr6VYRDQMDgqZo6bB8BGzpql>

Me 21.02.2025 konsultimi publik është mbajtur me qytetarë në Sallën e Mbledhjeve të Kryetarit duke filluar nga ora 10:00.

Pjesëmarrës në këtë konsultim ishin: Grupi Punues i Draft-Rregullores, Drejtorë të Drejtorive komunale, zyrtarë komunal, OJQ dhe të tjerë.

Konsultimin e hapi Kryesuesja e Grupit Punues, Qendresa Kastrati ku prezantoi disa nga ndryshimet e bëra tek Daft-Rregullorja:

“Me anë të kësaj Rregullore plotësohet dhe ndryshohet Rregullorja Sh.01 Nr.31251 e datës 29.09.2022 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së Subvencioneve.

Neni 6, paragrafi 3, nënparagrafi 3.3, pas nën nën paragrafit 3.3.1 shtohet nën nën paragrafi 3.3.2 me tekstin si në vijim:

3.3.2 Përjashtim nga nën nën paragrafi 3.3.1 bën subvencionimi i qumështit/litër

Neni 6, paragrafi 3, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

3. Përjashtim nga paragrafi 2 i këtij nenit bëjnë subvencionet e ndara për personat fizik në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, Kulturës, Rinisë dhe Sportit, subvencionet e ndara nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe zhvillim Rural si dhe nga Drejtoria për Zhvilim Ekonomik dhe Diasporë.

Neni 6, paragrafi 3, shtohet nënparagrafi 3.4 me tekstin si në vijim:

3.4. Përfituesi i trajnimit në punë dhe praktikës në punë për të papunësuarit në bazë të kohëzgjatjes të përcaktuar në kontratë mund të jetë përfitues i subvencionit të pagës më shumë se një herë brenda vitit.

Neni 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

1.1 Përjashtim nga paragrafi 1 I këtij nenit bëjnë subvencionet e ndara nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale tek subvencionet për Mirëqenie Sociale specifisht për subvencionet në Nenin 26, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1.

Neni 11, paragrafi 2, shtohet nënparagrafi 2.1 me tekstin si në vijim:

2.1. Ndaj vendimeve për ndihma momentale në fushën e shëndetësisë nuk lejohet e drejta e ankesës.

Subvencionet në fushën e Arsimit

Neni 15 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

1. Komuna mund të ndaj subvencione për arsim, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, në:
 - 1.1 Bursa për studentë;
 - 1.2 Bursa për nxënës të shkollës së mesme;
 - 1.3 Bursa për nxënës të shkollës fillore;
 - 1.4 Kuadro deficitar;
 - 1.5 Nxënësit me nevoja të veçanta;
 - 1.6 Botimin e librave dhe revistave;

2. Përfitues I subvencionit në arsim është nxënësi që në garat individuale :
 - 2.1 në nivel komunal zë vendin e parë, shpallet "Ylli I Shkollës" dhe shpërblehet me shumën 50 euro.
 - 2.2 në nivel komunal zë vendin e dytë, merr lëvdatë dhe shpërblehet me shumën 30 euro.
 - 2.3 në nivel komunal zë vendin e tretë, merr lëvdatë dhe shpërblehet me shumën 20 euro.
 - 2.4 në nivel regional-republikan zë vendin e parë, shpallet "Yll i Dardanës" dhe shpërblehet me shumën 100 euro.
 - 2.5 në nivel regional-republikan zë vendin e dytë, merr lëvdatë shpërblehet me shumën 80 euro.
 - 2.6 në nivel regional-republikan zë vendin e tretë, merr lëvdatë dhe shpërblehet me shumën 60 euro.
3. Përfitues I subvencionit në arsim është nxënësi që në garat grupore:
 - 3.1 në nivel komunal zënë vendin e parë, marrin lëvdatë dhe shpërblehen me shumën 20 euro për nxënës.
 - 3.2 në nivel komunal zënë vendin e dytë, marrin lëvdatë dhe shpërblehen me shumën 15 euro për nxënës
 - 3.3 në nivel komunal zënë vendin e tretë, marrin lëvdata dhe shpërblehen me shumën 10 euro për nxënës.
 - 3.4 në nivel regional-republikan zënë vendin e parë, shpallen "Yll i Dardanës" dhe shpërblehet me shumën 30 euro për nxënës.
 - 3.5 në nivel regional-republikan zënë vendin e dytë, marrin lëvdatë dhe shpërblehet me shumën 25 euro për nxënës.
 - 3.6 në nivel regional-republikan zënë vendin e tretë, marrin lavdatë dhe shpërblehet me shumën 20 euro për nxënës.
4. Mësimdhënësi, nxënësi/t i/e të cilit:
 - 4.1 merr lëvdaten "Yll i Shkollës", shpërblehet me shumën 100 euro.
 - 4.2 shpallet "Yll i Dardanës" shpërblehet me shumën 300 euro.
 - 4.3 zë vendin e dytë ose të tretë në garat regionale-republikane shpërblehet me shumën 200 euro.
5. Nxënësit fitues dhe mësimdhënësit do të shpërblehen vetëm një herë dhe atë për rezultatin më të lartë të arritur.
6. Mjetet do të barten në llogari të mësimdhënësit përkatës të nxënësit/ve garues i cili do ta dëshmoj tek Drejtoria e Arsimit për ndarjen e të hollave tek nxënësi/t

7. Mësimdhënësi, që perveç detyrave dhe obligimeve që përshkruhen në kontratë të punës, harton, aplikon dhe fiton:

7.1 Donacion për shkollën në vlerë mbi 1000 euro, shpërblehet me shumën 100 euro.

7.2 Donacion për shkollën në vlerë mbi 3000 euro, shpërblehet me shumën 200 euro.

7.3 Donacion për shkollën në vlerë mbi 5000 euro, shpërblehet me shumën 400 euro.

8. Nxënësi që merr lëvdatën YLL I DARDANËS i garantohet bursa në vitin e parë të studimeve.

9. Shkolla me performancën më të lartë në nivel komunal shpërblehet me një udhëtim jashtë Kosovës.

Neni 16, paragrafi 1 nënparografi 1.1 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

1. Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta:

1.1 Për student:

1.1.1	Nota mesatare, prej 9 deri në 10	30 pikë
1.1.2	Nota mesatare, prej 8 deri në 9	20 pikë
1.1.3	Nota mesatare, prej 7 deri në 8	15 pikë
1.1.4	Nota mesatare, prej 6 deri në 7	10 pikë
1.1.5	Studentet të cilët kanë fituar në garat sipas nenit 15 pika 2	10 pikë

Subvencionet në fushën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Neni 26, paragrafi 3, nënparagrai 3.1 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

3.1. Familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjar

Neni 26, paragrafi 3, shtohet nënparografi 3.5 me tekstin si në vijim:

3.5 Përkrahje financiare për viktimat e dhunës në familje

Neni 26, shtohet paragrafi 13 dhe 14 me tekstin si në vijim:

13. Përkrahje financiare për viktimat e dhunës në familje

13.1 Subvencionimi ndahet në tre (3) komponente:

13.1.1 Subvencionimi i banimit;

13.1.2 Subvencionimi i mjeteve për jetesë (aplikohet kur viktima nuk është përsituese nga skema e ndihmës sociale);

13.1.3 Në rast se viktima ka fëmijë në përkujdesje, kjo shumë rritet për secilin fëmijë;

13.2 Përsituesit e subvencioneve nga paragrafi 13 i këtij nenii jo domosdoshmërisht mund të jenë përsitues nga tre komponentet.

13.3 Ky subvencion mund të ofrohet në një afat prej 6 muajve i cili mund të vazhdohet jo më shumë se 2 vite por i njëjtë mund të ofrohet edhe në një afat më të shkurtër, por e njëjta mund të ndërpritet edhe më herët se sa është përcaktuar paraprakisht, sipas vlerësimeve të Qendrës për Punë Sociale dhe Komisionit përkatës.

Monitorimi i përsituesve të subvencioneve

Neni 29, paragrafi 4 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

4. Komuna në bazë të komisionit të monitorimit të cilin e formon Kryetari i Komunës harton raporte me listën e zezë për përsituesit të cilët nuk e kanë respektuar marrëveshjen për subvencionim si dhe saksione tjera.

Neni 29, shtohet paragrafi 5 dhe 6 me tekstin si në vijim:

5. Komuna në bazë të raportit të monitorimit ofron afat shtesë prej 30 ditësh për përsituesit të cilët nuk kanë realizuar projektin.

6. Komuna do të marrë masa ndëshkimore të cilat specifikohen në marrëveshje të nënshkruar nga të dyja palët, në rast të mospërputhjes së projektit dhe afatit shtesë sipas paragrafit 5 të këtij neni.

Pas prezantimit të **Draft-Rregulloren Nr. _____ për plotësim-ndryshim të Rregullores Sh.01 Nr.31251 e datës 29.09.2022** për **Kushtet, Kriteret dhe Proceduren e Ndarjes së Subvencioneve** është hapur diskutimi për pyetje dhe komente nga të pranishmit.

Pyetjet/Sugjerimet e të pranishmëve për dokumentin në fjalë:

Emri Mbiemri/Pyetja:

Ismet Ahmeti: Tek neni 34 duhet të fshihet më shumë se njëherë.

Poashtu tek subvencionet në fushën e arsimit nuk është e ligjshme në llogari të mësimdhënsve,

duhet te jetë të prindërve.

Tek lista e zeze duhet të shpérndahet tek të gjitha komisionet verifikuese të sektorëve të ndryshëm për subvencione. Të bëhet krijimi i një databaze dhe një zyrtar përgjegjës ta rifreskojë.


Filloreta Rexha: Edhe unë mendoj që tek shpérndarja e subvencioneve tek arsimi nuk duhet të dalin në xhirologari të mësimdhënësit por të prindërit. Sikurse dalin të gjitha subvencionet.

Shefi i Drejtorisë së Arsimit: Visar Krasniqi: Për 10 euro prindërit nuk po vijnë ti sjellin llogaritë e tyre, për këtë arsyе çdoherë dalin në xhirologari të mësimdhënësve dhe pastaj ata ua japin nxënësve fitues. Asnjëherë nuk janë keqpërdorur.

Petrít Vokshi: Tek subvencionet e shëndetësisë, më saktësish përfëmijët e posalindur të shtohet edhe për prindërit vetëushqyes, sepse po kemi probleme në verifikim të aplikacioneve.

Takimi ka mbaruar në orën: 11:30.

Procesmbajtës:





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Lista e pjesëmarrjes në Konsultimin Publik për Draft-Rregulloren Nr. _____ për plotësimi-ndryshim të Rregullores Sh.01 Nr.31251 e datës 29.09.2022 për Kushtet, Kriteret dhe Proceduren e Ndarjes së Subvencioneve.

Data:21.02.2025

Ora:10:00

Nr.	Emri dhe mbiemri	Vendi	Nënshkrimi
1.	ISMET AHMETI	KAMENICË	Ahmeti
2.	Mirzadile Shala	Kamenicë	Shala
3.	Iliroja Lubaku	Kamenicë	Lubaku
4.	Kadete Dapi	Kamenicë	Dapi
5.	Shefot Prudhoni	Kamenicë	Prudhoni
6.	Kadete Berisha	Kamenicë	Berisha
7.	Qendre Kastrioti	Kamenicë	Kastrioti
8.	Durim Bishaj	Kamenicë	Bishaj
9.	Selami Zymari	KAMENICË	Zymari
10.	Filloreta Rexha	Kamenicë	Rexha
11.			
12.			
13.			
14.			
15.			
16.			
17.			
18.			
19.			

20.			
21.			
22.			
23.			
24.			
25.			
26.			
27.			
28.			
29.			
30.			
31.			
32.			
33.			
34.			
35.			
36.			
37.			
38.			
39.			
40.			
41.			
42.			
43.			
44.			
45.			
46.			
47.			
48.			